



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 qershor 2024, në mbledhjen e XXV-të (njëzetepesë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 09:15

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; Mrika Thaçi, kurse mungoi Haki Rudari - lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; *Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF dhe i Autorizuar për ushtrimin e punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe fushveprimtaria e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Adelina Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Avni Fetahu Drejtor i Drejtorisë së Arsimit- DKA.*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi kuorumin, theksoi, për momentin të pranishëm në sallën e Kuvendit i kemi 6 anëtarë, ndërsa për momentin mungon z.Bashkim Syla i cili pritet të mbrinë shumë shpejtë, kurse mungon edhe z.Haki Rudari i cili më ka lajmëruar se do të mungojë në këtë mbledhje të KPF-së, kështu që mund të vazhdojmë me rendin e ditës, a dëshiron ndokush të marr fjalën lidhur me rendin e ditës, nëse nuk ka të interesuar për të marr fjalën atëherë e hedh në votim rendin e ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 7 anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa sa ishin prezent në sallë për momentin, njëzëri miratohet rendi i ditës i propozuar sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtura më 21.05.2024

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e KPF-së që ishin prezent, miratohet procesverbali sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore – KAB e Komunës së Podujevës 2025-2027

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, paraqiti fjalën hyrëse , theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është obligim ligjor që të miratohet brenda muajit qershor dhe është dokument që i paraprinë miratimit të buxhetit, andaj rekomandoj që të kalojë për miratim dhe shqyrtim në seancën e Kuvendit.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa sugjerimet dhe vërejtjet tona do ti japim në seancën e Kuvendit.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, edhe ne Grupi i LVV e përkrahim Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe e rekomandojmë për seancën e Kuvendit, ndërsa sugjerimet tona do të i japim në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, edhe unë e përkrahi këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndonjëri dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës 2025-2027.

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e KPF-së që ishin prezent, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës 2025-2027, rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes

3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1798-0, ZK Podujevë

3.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, së bashku me këtë pikë të rendit të ditës janë 11 pika gjithsejtë që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës dhe nëse e keni vullnetin i kishim kaluar në grup për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues është mirë që ti ta pyesësh KPF-në se a dëshiron ti bashkoj këto pika në një pikë të vetme, pra nëse KPF voton atëherë nuk ka pengesë ligjore për bashkimin e këtyre pikave. Nuk dua që të kem një adresë të fajësisë por që nga fillimi i këtij mandati vazhdimisht ka qenë vullneti i të gjithëve që pronën komunale të japim në shfrytëzim për zhvillimin ekonomik dhe të merr atë që të jetë pjesë e mirëqenies brenda territorit të Komunës dhe vërtetë është për keqardhje që për çdo seancë kemi kësi lloje të vendimeve, mirëpo ndoshta e gjitha kjo nuk varet nga ne.

Shumë prej atyre pronave të cilat kanë mundur të jenë si potencial, por janë mbetur të fjetura dhe po mbesin ashtu shkaku i procedurave dhe shkaku i mos interesimit. Vërtetë këtu nuk është prezent drejtoresha e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, mirëpo në një të ardhme besoj që është dashtë ne si Kuvend të trajtojmë këtë çështje, të krijojmë kushte më të favorshme dhe në gjetjen e mundësive sepse fundja e kam potencuar më shumë se njëherë që më e vlefshme është që nëse edhe 1 euro e japim një pronë në shfrytëzim se ta lëm ashtu si potencial të fjetur sepse po kemi atakime si në forma të uzurpimit dhe forma tjera pastaj.

Pra e përkrahim këtë por është dashtë që të trajtohet më seriozisht kjo temë në kuptimin e ruajtjes zhvillimit të pronës komunale ku për të cilën jemi edhe të thirrur, ndërsa është paksa e tepruar në kuptimin e tepruar jo për neve por për ata që janë përgjegjës për këtë që të trajtosh tema si kjo me rendësi. E di gjendjen dhe arsyen e drejtoreshës së DPKGJ dhe nuk kemi asnjë vërejtje përse nuk është prezent, mirëpo në anën tjetër ta trajtosh një dokument siç është KAB me prezencë kaq të vogël të kabinetit të Ekzekutivit, është joserioze.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, të gjitha këto pika të rendit të ditës të cilat janë për dhënien e pronës në shfrytëzim janë të ngjashme, por po e shoh që është numër i madh i tyre dhe ne mund të kemi probleme sepse Kuvendi i Komunës përbëhet prej vetëm 35 anëtarëve dhe kemi administratën që organizohet në 11 Drejtori, kështu që për t'i dhënë 10 prona në shfrytëzim duhet t'i kemi nga 5 anëtar për çdo komision, pra që nënkupton duhet ti kemi 50 anëtar/e si dhe i kemi anëtarët nga Shoqëria Civile, andaj nuk e di sa janë paraqitur apo sa kanë aplikuar nga Shoqëria Civile.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, janë aplikime që janë paraqitur prej shoqërisë civile, kurse çështja tjetër është se ne kemi të drejtë që një asamblistë ose një drejtor i Drejtorisë të jetë në komision edhe për dy prona, kështu që kemi nga Shoqëria civile 4 anëtar të paraqitur po ashtu si pjesë e këtyre komisioneve.

Sa i përket bashkimit të këtyre pikave në një pikë të vetme mendoj se nuk mund ta bëjmë, por mund t'i kalojmë si grup në aspektin procedural dhe më shpejt në KPF, zakonisht duhet të miratohen edhe komisionet për çdo pikë që janë komisione të veçanta për çdo pikë të dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur ta bëjë temë këtë që nuk duhet të bëhet temë e diskutimit dhe në mungesë të z.Haki Rudarit, po e përmendi Rregulloren, e që na mundësohet bashkimi i pikave dhe duhet të vendos Kuvendi për këtë, mirëpo sido që vendosem nuk është problem.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë mendoj që në Kuvend për çdo propozim të formohet komision sepse nuk e kemi për herë të parë dhe kemi provojë në këtë drejtim, andaj duhet të shkohet me radhë për secilën pikë të rendit të ditës, kështu që në Kuvend nuk besoj që është interes as i joni si Kuvend që t'i bashkojmë pikat sepse na dalin probleme pastaj. Pastaj është mirë që në Kuvend kur japim propozime për anëtar/e të komisioneve të respektohet kuota gjinore në mënyrë që tek çdo komision të ketë barazi gjinore qoftë nga Kuvendi qoftë nga Ekzekutivi duhet të respektohet kuota gjinore ngase po kemi vërejtje edhe nga Ministria mandej për këtë çështje, prandaj kërkoj të respektohet kuota gjinore në mënyrë që të mos na kthehen pikat në rishqyrtim shkak i kësaj.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim propozimin që pikat në kuadër të rendit të ditës me renditje nga 3 deri 13 të bashkohen në një pikë të vetme për shqyrtim në këtë mbledhje.

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e KPF-së që ishin prezent, mbështet propozimi që pikat nga 3 deri 13 sipas rendit të ditës, të bashkohen në një pikë të vetme për shqyrtim në këtë mbledhje, dhe atë pikat si në vijim:

3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1798-0, ZK Podujevë

3.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

4. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-2159-0, ZK Batllavë

4.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-893-0, ZK Batllavë

5.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-425-1, ZK Zakut

6.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-427-0, ZK Zakut

7.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-429-0, ZK Zakut

8.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

9. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-2, ZK Revuç

9.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

10. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-3, ZK Revuç

10.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

11. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme

11.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-202-1, ZK Lupç i Poshtëm

12.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-209-0, ZK Lupç i Poshtëm

13.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

Pas shqyrtimit dhe hedhjes në votim të pikave të rendit të ditës të renditura nga 3 deri në 13, Njësëri me 8 vota Për, nga anëtarët e KPF-së që ishin prezent, në pako i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 09:35

Procesverbalin e mbajti;

Sabedin Namani

Nr.Prot.01-060/04-0041844/24

Podujevë, 27 qershor 2024

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha